


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1460 Rep.
Nr. 449 kol.



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me daten 19/2.2004 ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje **Noteres Mimoza Shehu** u paraqiten personalisht te interesuarit si me poshte me cilesine e shitesit dhe bleresit te cilet ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil si dhe te Ligjit "Per shoqerite tregtare" kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

SHITESI: Halil Lleshi, i biri i Rezhepit, dtl.1966, lindur dhe banues ne Burrel, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga licensa me nr.N.2894/1.

DHE

BLERESI: Hamdi Lleshi, i biri i Rexhepit, dtl.1969, lindur dhe banues ne Burrel, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i njohur personalisht prej meje Noteres.

OBJEKT: Transferimin e kuotave te shoqerise "BLENDI" shpk qe i perkasin Z.Halil Lleshi ne mbeshtetje te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" neneve 62,63 dhe neneve te Statutit te shoqerise tregtare "**BLENDI**" shpk.

Sipas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur deri ne ditën e sotme te shoqerise "**BLENDI**" shpk, shoqeri kjo e regjistruar si person juridik me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.18686 date 6.2.1998.

Ortaku i shoqerise "BLENDI" shpk zoteron

Z. Halil Lleshi zoteron 100%, te kuotave te kapitalit,

Ne mbeshtetje te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" nenit 62,63 dhe neneve perkates te Statutit te shoqerise tregtare "**BLENDI**" shpk shitesi dhe bleresi bien dakort midis tyre per shitjen e kuotave si me poshte vijon:

1) Shitjen e pjesshme te pjeseve te kapitalit te shoqerise me menyren si vijon:

Z.Halil Lleshi i cili aktualisht zoteron 100% te kapitalit ia shet: Z.Hamdi Lleshi 100% te kapitalit kundrejtshumes 100.000(Njeqind mije), i cili deklaroi se eshte dakort ti bleje ato.

Perfundimisht kapitali i shoqerise "BLENDI" shpk do te perbehet nga ortaku i saj Z.Hamdi Lleshi i cili zoteron 100% te kuotave te kapitalit i cili merr persiper nga ky moment gjithë te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga administrimi i kesaj shoqerie.

Kontrata si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te paleve nenshkruset
vullnetarisht ne prani te noteres nga shitesi dhe bleresi dhe une noterja
legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.

Kontrata u redaktua ne tre kopje me fuqi te barabarte secila,ku njera
prej tyre arkivohet ne kete zyre noteriale.

SHITESI

HALIL LLESHI

Halil Lleshi
10/04/04

BLERESI

HAMDI LLESHI

Hamdi Lleshi
[Signature]



Notere
Mirzoza Shehu
Tel: (04) 232 453, (04) 227 425